

Oral History Kosovo

INTERVISTË ME GENNY PETROTTA

Online | Data: [...]

Kohëzgjatja: 41 minuta

Të pranishme:

1. Genny Petrotta (E intervistuar)
2. Ana Morina (Intervistuese)
3. Diona Budima (Intervistuese)

Ana Morina: Fillimisht, a mund të na thoni emrin dhe mbiemrin tuaj dhe nga vini?

Genny Petrotta: Unë jam Genny Petrotta. Vij nga Piana degli Albanesi, një fshat arbëresh në Sicili.

Ana Morina: A mund të na tregoni pak për formimin tuaj, si jeni rritur, për fëmijërinë tuaj dhe si arritët të merreshit me art?

Genny Petrotta: Në rregull. Jam artiste vizuale dhe punoj me filmin dhe performancën. Meqë u rrita në një fshat shumë të vogël, ku nuk kishte as kinema, as teatër dhe as galeri arti, gjatë fëmijërisë sime ndodhi kjo: një regjisor shqiptar erdhi në fshatin tim dhe më kërkoi ta ndihmoja me disa hulumtime, me gjetjen e njerëzve, të lokacioneve dhe me gjithçka tjetër. Isha pesëmbëdhjetë vjeçe dhe u gëzova jashtëzakonisht shumë. Mendova: “Në rregull, të punojmë bashkë.” Ishte verë.

Më pas u bëra shumë kureshtare. Studiova latinisht dhe greqisht në qytet, në Palermo. Kur fillova universitetin, nisa të studioja historinë e kinemasë dhe filozofinë. Ndërkohë që studioja, edhe punoja. Punoja në produksione filmike, herë si asistente regjie dhe herë si operatore kamere. Pastaj fillova të mësoja edhe montazhin. Pra, kisha një formim shumë teorik për kinemanë dhe artin, por, paralelisht me studimet, merresha gjithnjë e më shumë edhe me punën praktike.

Në vitin 2016 themelova një kolektiv me katër persona. Merreshim kryesisht me videoinstalacione dhe punonim për festivale e bienale. Punuam në Manifesta, si edhe në hapësira të ndryshme arti në Itali dhe vende të tjera. Ndërkohë, vazhdoja të punoja në produksione filmike dhe, në veçanti, me artistë të tjerë nga Italia dhe jashtë saj. Merresha me pjesën e produksionit dhe me hulumtimin. Pastaj, gjatë katër... jo, pesë vjetëve të fundit, vendosa të punoja edhe në projektet e mia. Fillova të kërkoja fonde dhe mundësi.

Është gjithmonë e çuditshme kur dikush të pyet se kur ndodhi e gjithë kjo. Ndoshta vendosa të krijoj imazhe sepse, kur isha fëmijë, shkruaja poezi. Ndoshta kjo është përgjigjja më e sinqertë që mund t’ju jap.

Ana Morina: Çfarë ju tërhoqi te Vila 31 dhe si erdhi deri te kjo? Gjithashtu, për ata që nuk kanë qenë në hapje, a mund të na tregoni se çfarë përmbante ekspozita...?

Genny Petrotta: Para disa vjetësh shkrova një përmbledhje të idesë së këtij projekti. Vitin e kaluar thashë: “Në rregull, le të përpiqemi ta ndërtojmë. Le të përpiqemi ta realizojmë.” Një mikesha ime, e cila po punonte gjithashtu në produksionin e projektit, ma dërgoi thirrjen për aplikim. Për mua ishte e vetmja... ndoshta është më mirë të filloj nga vetë projekti.

Meqë jam rritur në Piana degli Albanesi, që është një komunitet arbëresh, disa vjet më parë fillova ta lexoja Kanunin. Aty hasa figurën e burrneshës dhe më la shumë mbresë. Por, kur fillova të bëja

hulumtime, e kuptova shumë qartë se kjo temë ishte konsumuar dhe keqtrajtuar shumë nga mediat dhe kultura perëndimore.

Në fillim mendova: “Në rregull, ndoshta nuk duhet të përqendrohem te kjo temë.” Por më pas, edhe më fuqishëm, mendova: “Ndoshta ka ende diçka për të bërë me të”, qoftë edhe për të ndryshuar vështrimin tim ndaj kësaj teme.

Për këtë arsye, mendova se ishte shumë e rëndësishme të shkoja në Shqipëri. Para kësaj, kisha kaluar rreth dy muaj në Prizren, në Kosovë, ku po punoja në një projekt tjetër për Autostrada Biennale. Shikoja vazhdimisht malet në kufirin mes Shqipërisë dhe Kosovës dhe mendova: “Në rregull, duhet të lëviz. Duhet t’i rikthehem këtij projekti.”

Pastaj, papritur, kjo mikeshë ime ma dërgoi thirrjen për aplikim. Aplikova edhe në Itali për një fond, një grant për artet performative, dhe e fitova. Ishte diçka e përkryer, sepse kisha një rezidencë të gjatë në Shqipëri, mbështetje dhe fonde nga Italia për pjesën performative, si edhe disa festivale ku mund ta prezantonim shfaqjen.

Vila 31 nuk është thjesht një rezidencë artistike në Tiranë. Është një vend shumë i fuqishëm dhe i ngarkuar. Në njëfarë mënyre, ishte vendi i përkryer për projektin tim, sepse projekti lidhej me pushtetin, autoritetin, gjininë dhe vdekjen. Korniza poetike që kisha zgjedhur për projektin ishte Hamleti, ndërsa shtëpia e dikurshme e Enver Hoxhës ishte një vend i jashtëzakonshëm edhe për këtë.

Kur mbërrin atje dhe e kupton se ajo shtëpi kishte qenë e mbyllur për shumë vjet, kupton se po jeton në shtëpinë e dikurshme të një vrasësi. Prandaj, gjithçka është shumë e rëndë. Megjithatë, duhet të them se, falë banorëve të tjerë dhe njerëzve që punonin aty, arritëm të ndërtonim një komunitet shumë të bukur. Ishte shumë interesante të ishim pjesë e transformimit të vilës. E mbështetnim njëri-tjetrin në një mënyrë shumë të bukur dhe jam e lumtur që gjeta aty njerëz kaq të mirë.

Sa i përket punës sime, për studion e hapur vendosa ta krijoja instalacionin në dhomën time, në studion time, e cila kishte qenë dhoma e Pranverës. Ishte një videoinstalacion me tri kanale. Kishte një projektion të madh në mur dhe një ekran vertikal.

Zgjodha një poezi të Amelia Rossellit, e cila vdiq nga vetëvrasja në vitin 1996. Ajo e kishte rishkruar monologun e Hamletit. Për këtë punuam me Ledia Dushin, e cila është poete, akademike dhe përkthyes nga Shkodra. Fillimisht e kontaktova sepse kishte bërë një hulumtim shumë të bukur, të fuqishëm dhe të thellë për gjamën e burrave.

Mendova: “Meqë punoj edhe me artet performative, si mund ta mishëroj këtë partiturë gjestuale mashkullore?” Prandaj ftova dy performues të punonin me mua. Gjatë fazës së punës në vilë ishte vetëm njëri prej tyre dhe punuam kryesisht me gjamën. Falë Ledias dhe hulumtimit të thellë që ajo kishte bërë në terren gjatë viteve të mëparshme, e realizuam performancën në bodrumin e vilës. Ishte shumë intensive edhe për faktin se ky ritual kishte qenë i ndaluar gjatë regjimit komunist.

Së bashku me Ledian e përkthyer edhe poezinë e Amelia Rossellit. Ndërkohë, shkoja shpesh në Lezhë, sepse atje ishte Drandja, një burrneshë nga Lezha. Zhvillova një bisedë me të, të cilën e prezantova në formë të shkruar, por ajo shfaqet edhe në videon që prezantova në vilë. Në ekranin vertikal shfaqeshin tri kanale të gjamës së burrave, ndërsa në tavan kishte një projeksion. Kështu ishte ndërtuar hapësira. Mund t'ju dërgoj materialin, sepse është gjithmonë e vështirë ta shpjegosh me fjalë. Ishte një instalacion gjithëpërfshirës, prandaj ndoshta është më mirë t'ju dërgoj disa fotografi dhe video që ta kuptoni më mirë.

Pas hapjes, kur u ktheva në Itali, duhej ta prezantoja performancën në festivalin Santarcangelo dei Teatri, një festival i arteve performative në Itali. E dhamë performancën nëntë herë në Santarcangelo, pastaj në Centrale Fies. Projekti vazhdon ende. Duhet ta prezantojmë përsëri vitin e ardhshëm në Trienalen e Milanos. Gjithashtu, po punoj edhe në pjesën filmike të projektit. Pra, është ende një projekt në zhvillim.

Rezidenca ishte e përkryer për shumë arsye. Vërtet për shumë arsye.

Ana Morina: Dua të kthehem edhe një herë te jetesa në vilë. E kuptoj se, për shumë njerëz vendas, ky ishte një vend që mbart ende shumë kujtime dhe trauma. A ndikoi kjo në procesin tuaj ose në mënyrën se si e kishit përfytyruar punën në fillim dhe në atë që u realizua në fund? Nga sa kuptoj, ju angazhoheni shumë me këto rrëfime historike. Por cili është procesi i vendosjes së tyre në një kontekst bashkëkohor dhe vendor?

Genny Petrotta: Sigurisht që nuk është një hapësirë neutrale. Është e çuditshme, sepse, sapo mbërrin, kupton se po jeton në të njëjtën hapësirë ku ka jetuar familja Hoxha dhe duhet të përballesh me këtë. Sigurisht që duhet të përballesh edhe me shumë ndjenja.

Shihja shumë ëndrra atje. Për shembull, ëndrra e parë që pashë ishte se po më helmonin. Besoj se kjo është trauma e çdo diktatori. Këtë lidhje e kuptova vetëm pas disa javësh. Çdo mëngjes i shkruaja të gjitha ëndrrat e mia. Duhet të them se ishin shumë të gjalla. Kohët e fundit nuk shoh zakonisht ëndrra kaq të gjalla, megjithëse në përgjithësi jam mësuar t'i mbaj mend ëndrrat e mia.

Kjo e ndryshoi të paktën fazën e parë të projektit. Për mua, ai vend lidhet tërësisht me pushtetin, autoritetin dhe vdekjen. Si mund të përkthehet kjo në një vepër? Ka shumë mundësi dhe çdo person mund ta trajtojë në shumë mënyra të ndryshme. Mendoj se përfundova duke punuar me gjamën e burrave sepse ajo lidhej drejtpërdrejt me vdekjen dhe, në njëfarë mënyre, edhe me trashëgiminë e vilës, pasi kishte qenë e ndaluar gjatë asaj periudhe.

Kjo i shtoi diçka tjetër punës sime. Nuk doja të riprodhoja temat sensacionaliste dhe ekzotizuese rreth burrneshave që gjenden në kulturën perëndimore. Për mua, kjo ishte një mënyrë shumë e drejtpërdrejtë për t'u angazhuar dhe për ta mishëruar diskutimin, duke e jetuar atë përmes trupit dhe poezisë.

Sidomos në vende të tilla, duhet të... Kur e kupton se po jeton në shtëpinë e dikurshme të një vrasësi, edhe mënyra se si e sheh gjithçka cenohet disi. Nga ballkoni im kisha një pamje shumë të bukur, një terracë të mrekullueshme, por... domethënë...

Flisja shumë edhe me njerëzit në Tiranë për atë vend, për simbolin që përfaqësonte në qytet dhe për mënyrën se si reagonin ndaj ardhjes së një institucioni francez që po e transformonte. Ka shumë çështje delikate. Megjithatë, në fund, mendoj se hapja ishte një moment shumë i rëndësishëm.

Një vend që kishte qenë plotësisht i ndaluar për publikun, më në fund iu hap publikut dhe po e përfshinte atë drejtpërdrejt. Tani mbetet të shohim. Jam shumë kureshtarë të shoh se si kjo do ta ndryshojë këndvështrimin e njerëzve atje dhe se çfarë mund t'u shtojë hulumtimeve personale të artistëve që do të jetojnë në atë hapësirë.

Ana Morina: A mund të na tregoni pak edhe për pjesën e hulumtimit historik, për mënyrën se si shiheshin këto rituale dhe tradita gjatë regjimit komunist në Shqipëri dhe për atë që mësuat? E dimë se ato ishin të ndaluara dhe se shumë gjëra përpiqeshin të mbijetonin në mënyra shumë të fshehta. A mund të na tregoni pak për kontekstin historik të këtyre dy traditave, burrneshës dhe gjamës së burrave?

Genny Petrotta: Në lidhje me gjamën, siç ju thashë, ishte shumë e rëndësishme të punoja me Ledia Dushin, sepse ajo është akademike dhe kishte zhvilluar një hulumtim shumëvjeçar në terren. Mendoj se gjamën e pashë për herë të parë gjatë një ligjërate të Olsit nga Instituti i Antropologjisë në Tiranë. Po e zhvillonim atë ligjëratë në vilë dhe e kuptova se ishte diçka që më fliste, në kuptimin se duhej të bëhej pjesë e veprës.

Ajo që zbulova dhe që më dukej shumë interesante ishte se kjo partiturë gjestesh, megjithëse është shumë karakteristike për Shqipërinë, në njëfarë mënyre u përket edhe traditave të tjera. Vetë gjesti është shumë elementar. Kjo ishte veçanërisht interesante sepse më pas duhej të punoja me një performues tjetër për versionin në Itali. Ishte interesante të shihje se si dy performues të ndryshëm e mishëronin të njëjtin gjest të thjeshtë në mënyra rrënjësisht të kundërta.

Edhe të flasësh për burrneshat nga një vështrim perëndimor mund të mbetet diçka shumë e zbrazët. Sepse, para së gjithash, përtej të qenit burrneshë, je Drande, je Jeta dhe je gjithçka tjetër që përbën një person. Zhvillova një bisedë edhe me Jeta Lubotenin, e cila është hulumtuese klinike. Ajo ka jetuar si burrneshë nga mosha tetëmbëdhjetë deri në njëzet e tetë vjeç. Është nga Kosova, por jeton në Amerikë. Ishte shumë e rëndësishme për mua të flisja me të.

Në fund, pasi kishim zhvilluar shumë biseda për këtë çështje, ia dërgova pamjet e xhiruara. Për mua ishte shumë e rëndësishme të ndieja se, në njëfarë mënyre, po depërtonim nën lëkurën e temës. Shpresoja të vazhdoj me projektin dhe të thellohem gjithnjë e më shumë në të.

Ana Morina: Dua të flasim pak për idenë e ritualeve. Mendoj se ju kam dëgjuar të thoni diku, në një intervistë, se ideja është të kuptojmë se si i krijojmë ritualet. Dua t'ju pyes edhe se si mendoni se këto rituale mund të riinterpretohen në hapësira artistike. A ekziston ideja se ndoshta po e rikrijojmë ritualin dhe se ai po e lidh përsëri komunitetin? Apo thjesht po e ripërfytyrojmë dhe kjo bëhet diçka më kalimtare, ndoshta me një ton më intelektual dhe reflektues? Si e shihni ju këtë?

Genny Petrotta: Jam rritur në Sicili, një vend ku ritualet dhe lidhja e njerëzve me to vazhdojnë ende në njëfarë mënyre. Por pyetja se si krijohet një ritual dhe se si rikrijohet ai është shumë e vështirë për t'u përgjigjur. Në njëfarë mënyre, rituali është diçka që u përket të gjithëve, diçka kolektive, por mund të jetë edhe diçka shumë individuale.

Kur po mendoja për mënyrën se si bëhet dikush burrneshë, kuptova se edhe ky është një ritual. Në ritin e kalimit i pret flokët, vishesh si burrë dhe pastaj, kur vdes, varrosesh si burrë. Në shoqëri [e padëgjueshme 23:42] si burrë.

Pra, kjo është diçka që vazhdon të ndodhë. Jemi mësuar të mendojmë se ritualet janë diçka e vjetër, por ato vazhdojnë të ekzistojnë. Sigurisht, ndoshta më pak se në shekullin e kaluar, por përsëri kanë të bëjnë me identitetin. Nuk bëhet fjalë vetëm për identitetin e një vendi, por për identitetin e botës.

Gjithmonë më ka bërë përshtypje diçka që lexoja te James Frazer, një antropolog i shekullit të kaluar: i njëjti dreq ritual i zjarrit ekzistonte si në Skoci, ashtu edhe në Kongo, para një mijë vjetësh.

Pra, jemi gjithmonë më të afërt sesa mendojmë. Pikërisht për këtë arsye më trishtonte leximi i të gjitha intervistave perëndimore për burrneshat. Gjithmonë paraqitej sikur: "Oh, është një vend shumë i vjetër, ende i lidhur me rituale të lashta, është diçka..." Por jo, kjo nuk është diçka e keqe.

Prandaj, duke iu rikthyer ndoshta përdorimit të Hamletit si kornizë poetike, Hamleti nuk i përket vetëm Shakespeare-it. Hamleti gjendet kudo. Vjen nga një legjendë e Veriut, prej shumë e shumë vjetësh. Ekziston edhe një Hamlet persian. Ekziston edhe Hamleti i Amelia Rossellit.

Pra, është diçka që, përsëri, u përket të gjithëve. Është një rit kalimi që flet për hakmarrjen, gjininë dhe vdekjen. Mendoj se përdorimi i trupit na jep mundësinë të punojmë në një mënyrë universale.

Ana Morina: Po. Për të folur pak për këtë, mendoj se në punën tuaj flisni shumë për gjininë. Sidomos te burrneshat, bëhet shumë e qartë çfarë do të thotë të jesh burrë dhe çfarë do të thotë të jesh grua. Por edhe te gjama e burrave, më duket se vetë rituali është aq shprehës dhe emocional, sa nuk përputhet me figurën se si duhej të ishte, ndoshta, burri modern komunist. Si i lidhni këto në punën tuaj me teorinë apo çështjet e sotme gjinore?

Genny Petrotta: Mendoj se e bëj si në rrafshin teorik, ashtu edhe në një mënyrë shumë praktike. Vetë përdorimi i gjamës dhe i partiturës së saj gjestuale, si dhe puna me një performuese grua që i mishëron ato gjeste, tashmë është diçka që... nuk lidhet vetëm... Mendoj se të gjitha ne, meqë jemi

gra, e kemi mishëruar fizikalitetin mashkullor. Në mënyrat tona, mishërojmë edhe fizikalitetin dhe anën mashkullore.

Ishte një mënyrë për të kuptuar se si... Më falni, e humba fillin.

Ana Morina: Si e mishërojmë maskulinitetin?

Genny Petrotta: Si e mishërojmë maskulinitetin, po. Në punë, në... Është diçka që, përsëri, u përket të gjithëve dhe kjo ishte ideja. Nuk e di, nga përvoja juaj, a ju ka ndodhur ndonjëherë ta mishëroni anën mashkullore, një mënyrë mashkullore të të qenit, në punë, në familje apo...?

Ana Morina: Po.

Genny Petrotta: Mendoj se të gjithë e kemi këtë lloj...

Ana Morina: Për mua lidhet më shumë me idenë e feminitetit dhe maskulinitetit, mënyrën se si i mishërojmë të dyja dhe se si kjo ndryshon përmes kulturës dhe historisë. Mendoj se sot është pak më e lehtë t'i shprehësh të dyja, por...

Genny Petrotta: Po, por ende jo gjithkund dhe jo për të gjithë ne. Ndoshta pikërisht për këtë ende duhet të [e padëgjueshme 29:17] diçka përmes punës sonë, çfarëdo pune që bëjmë, që ta kuptojmë këtë. Për shembull, në Greqi, në teatër dhe në tragjedi, kur kishte personazhe gra, ato interpretoheshin nga burrat. Pra, edhe kjo është një mënyrë për të kuptuar se si funksionon kjo në jetë, në performancë, në art dhe gjithkund, mendoj.

Ana Morina: Folët pak për mënyrën pothuajse ekzotizuese se si Perëndimi i sheh *burrneshat*. Por si ishte për ju takimi me Dranden në Lezhë? Si ia shpjeguat asaj atë që po bënit dhe që po përpiqeshit të arrinit? Si ishte marrëdhënia mes jush?

Genny Petrotta: Fillimisht, nisëm... domethënë, unë fillova të pija *raki* në orën nëntë të mëngjesit. Ajo bën raki të mrekullueshme, megjithëse vetë nuk pi më prej pesëmbëdhjetë vjetësh. Pastaj ia shpjegova projektin. Mund t'jua dërgoj edhe bisedën që zhvilluam, e cila lidhej më shumë me ritin e kalimit, përvojën e saj personale, ëndrrat dhe...

Për mua, qasja e mediave perëndimore ndaj kësaj teme ishte dhe vazhdon të jetë shumë paternaliste, sepse është tepër gjyquese. Nuk dua ta quaj "budallaqe". Do të ishte e vërtetë ta thosha kështu, por njëkohësisht edhe vetë ky cilësim do të ishte i gabuar, sepse nuk bëhet fjalë për budallallëk. Është diçka e qëllimshme.

Prandaj ishte jashtëzakonisht e rëndësishme për mua të flisja me të dhe të kuptoja se si kishte vendosur ta mishëronte atë rol në shoqëri. Pastaj është gjithë ai ankimi i kulturës perëndimore: "Vajza e shkretë, duhet të [e padëgjueshme 31:49] për seksin, bla, bla, bla." Ajo ishte shumë e drejtpërdrejtë dhe jashtëzakonisht e fortë, ndoshta një nga njerëzit më të fortë që kam takuar në jetën time.

Çfarë mund të them? Dua thjesht ta takoj përsëri. Po thellohem gjithnjë e më shumë në këtë temë dhe kaluam disa ditë shumë të bukura së bashku. Ajo më tregoi edhe se si zakonisht ekipet e xhirimit vinin dhe thoshin: “Duhet të bëjmë këtë, këtë dhe këtë.” Kjo është një mënyrë krejtësisht jokonstruktive për ta përdorur një temë pa krijuar asnjë lidhje.

Pikërisht për këtë arsye, ajo që lexon për këtë temë është shpesh shumë e pakuptimtë. Në përgjithësi, jemi të mbingarkuar me informacione, dhe kjo vlen për çdo temë. Si pasojë, e humbasim pjesën më të thellë të njerëzve dhe të gjithçkaje.

Diona Budima: Isha kureshtarë të dija se si i lidhni këto kanale të ndryshme me njëri-tjetrin: burrneshën, gjamën dhe Hamletin. Ekziston një fije që lidhet me ndërrimin e roleve gjinore, apo jo? Burrneshja vishet si burrë, një grua performon gjamën, e cila tradicionalisht u përket burrave, dhe pastaj përfshihet edhe interpretimi që Amelia Rosselli i bën, në njëfarë mënyre, Hamletit. Por pse i zgjodhët pikërisht këto korpuse? Në njëfarë mënyre, të gjitha janë shumë kanonike, apo jo? Në folklorin shqiptar, burrneshja dhe gjama janë shumë kanonike, ashtu siç është edhe Hamleti, ndoshta vepra më kanonike nga të gjitha. Pse i zgjodhët pikërisht këto fenomene?

Genny Petrotta: Sepse ndjesia ime ishte dhe vazhdon të jetë se të gjitha këto elemente zhvillonin një dialog të mirë dhe të thellë me njëri-tjetrin, gjatë gjithë procesit dhe projektit. Në Tiranë, në Vilën 31, ishte vetëm videoinstalacioni. Pastaj, në Itali, kishim shfaqjen me muzikë të drejtpërdrejtë, videoinstalacionin dhe performuesen brenda hapësirës.

Për mua ishte edhe diçka e tillë: tani po shkoj në Itali dhe publiku do ta përfaqësojë vështirimin perëndimor. Nuk do të jetë një publik ballkanik. Kishte edhe disa njerëz nga Ballkani, por ishte kryesisht një publik ndërkombëtar, veçanërisht nga Italia. Prandaj mendova: “Le të krijojmë një hapësirë gjithëpërfshirëse për ta kuptuar këtë. Le të hyjmë nën lëkurën e kësaj teme. Le të krijojmë diçka ëndërrimtare, por njëkohësisht të qasshme për të gjithë.”

Për mua nuk bëhej fjalë për të shkruar një ese për *burrneshat* apo për *gjamën e burrave*. Unë vetë nuk i kam përjetuar ato. Por, meqë më pëlqen të punoj me identitetin, poezinë dhe filmin, kjo ishte mënyra për t'i lidhur të gjitha së bashku. Pastaj, nuk e di nëse keni parë ndonjë fotografi apo video, sepse unë po flas për këtë, por mendoj se pjesë e përvojës është të gjendesh brenda asaj hapësire ose, të paktën, të shohësh diçka prej saj.

Ana Morina: Na treguat pak për të ardhmen e projektit, se ai vazhdon dhe se do të prezantohet përsëri. Por thatë gjithashtu se dëshironi të realizoni një film, nëse...

Genny Petrotta: Po. Po. Po. Po. Po. Po.

Ana Morina: Për të gjithë projektin apo vetëm për burrneshat? Nuk e di nëse...

Genny Petrotta: Është... domethënë, po, është një film. Përfshin gjithçka që kemi bërë deri tani. Por dua ta zhvilloj më tej edhe sa i përket kornizës poetike të Hamletit. Po shkruaj për të dhe shpresoj të kthehem së shpejti në Shqipëri dhe Kosovë për ta zhvilluar fazën e ardhshme të projektit.

Ana Morina: Diona, nëse nuk ke pyetje të tjera, në fund ajo bëri një pyetje shumë të bukur: “Çfarë ju emocionon kur mendoni për të ardhmen, qoftë në aspektin shoqëror, artistik apo thjesht personal?”

Genny Petrotta: Nuk ka ndarje mes shoqërores, artistikes dhe personale. Të gjitha janë të lidhura. Tani po punoj në një performancë që do ta prezantojmë në Palermo, gjatë Mercurio Festival, së bashku me një grup njerëzish. Është një krijim kolektiv për një grua që, katërqind vjet më parë, u shiste helm grave që jetonin në martesë të tmerrshme dhe ishin aq... Pastaj ajo u vra në sheshin e Palermos. Pra, tani po punojmë për këtë.

Është një projekt ndërkombëtar, sepse në të po punojnë italianë, francezë dhe iranianë. Do të jetë një video dhe një performancë rreth njëzet minuta, të cilën do ta prezantojmë në fund të shtatorit.

Meqë punoj si profesioniste e pavarur, po punoj gjithashtu në një film të dy artistëve me të cilët bashkëpunoj prej dhjetë vjetësh, Masbedo. Po punojmë në një film që zhvillohet mes Islandës dhe Strombolit, një ishull i vogël vullkanik në Sicili. Tani dëshiroj të siguroj fonde për të vazhduar dhe për ta çuar më tej projektin tim [e padëgjueshme 39:39]. Gjithashtu, po punoj për krijimin e një arkivi arbëresh të komunitetit tim, një arkiv pamor dhe zanor. Kjo është një punë afatgjatë, në fakt është puna e një jete të tërë. E fillova vitin e kaluar dhe mendoj se do ta përfundoj kur të vdes. Kjo më emocionon shumë.

Ana Morina: Faleminderit. Kam edhe një pyetje shtesë. Si ishte ta prezantonit këtë vepër të veçantë në Tiranë dhe pastaj në vende të tjera? A kishte një ndjesi tjetër për ju?

Genny Petrotta: Po mendoja se sigurisht që po, sidomos në fillim, kur isha në Tiranë. Por duhet të them se publiku dhe organizatorët ishin shumë të kënaqur me punën. Në fund, reagimi ishte pothuajse i njëjtë edhe jashtë vendit, si në Itali. Për mua kjo ishte diçka e mirë, sepse, në njëfarë mënyre... Do të shohim. Jam ende kureshtarë, sepse do të kemi një prezantim tjetër në Triennale Milano, por dua të propozoj një zgjerim të veprës. Të shohim.

Ana Morina: Në rregull. Ju faleminderit shumë që ndatë kohën tuaj për të biseduar me ne.

Genny Petrotta: Faleminderit.

Diona Budima: Po, ishte kënaqësi t’ju takojmë.